

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2435/2 Prot.

Durrës, më 24.10.2025

VENDIM

Nr. 114, datë 24.10.2025

PËR

**"MIRATIMIN E OFRIMIT TË KURSIT TË GJUHËS SHQIPE NGA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE DHE DEPARTAMENTI I LETËRSISË,
PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR
MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 6 ; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Statutin e UAMD-së; në Rregulloren e UAMD-së; në "Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës për periudhën 2025-2027" miratuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 67, datë 04.06.2025; në "Strategjinë Afatshkurtër për procedurën e rekrutimit të studentëve të huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2025-2026" miratuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 79, datë 08.07.2025; referuar shkresës së Drejtuesit të Njesisë Kryesore të Fakultetit të Edukimit me Nr. 2081 prot., datë 06.10.2025; si dhe në relacionin Nr. 2081/3 prot., datë 16.10.2025 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e ofrimit të kursit të gjuhës shqipe, për studentët e huaj, nga Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Departamenti i Letërsisë, pranë Fakultetit të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore i Fakultetit të Edukimit
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

